

Mesazhet kryesore për menaxherët / administratorët e spitaleve

Detyrat

1. Detyrat tuaja lidhur me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve janë [31,42,56,71,75]:

- a) Krijimi i një ekipi multidisiplinar për programin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve (kujdestaria e antibiotikëve) në spitalin tuaj. Ky ekip duhet të përfshijë specialistë në fushën e sëmundjeve infektive, mikrobiologë klinikë dhe farmacistë dhe duhet të ketë fonde dhe burime të dedikuara;
- b) Mbështetja e zbatimit të udhëzimeve për përdorimin e antibiotikëve dhe masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksionit;
- c) Zbatimi i aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve që kanë për qëllim:
 - i. të optimizojnë menaxhimin diagnostik dhe terapeutik të pacientëve;
 - ii. të sigurojnë zbatimin e rekomandimeve për administrimin e përgjegjshëm të antibiotikëve;
 - iii. të adresojnë faktorët e sjelljes që kushtëzojnë keqpërdorimin e antibiotikëve;
 - iv. të mbështesin parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe përhapjen e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve.
- d) promovojnë bashkëpunimin e mjekëve me drejtuesit e ekipit të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve përmes realizimit të auditit proaktiv dhe informatave kthyese.
- e) vendosin tregues të cilësisë dhe metrikë sasiore për të matur progresin dhe rezultatet e programit të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve;
- f) sigurojnë që antibiotikët e listuar në formularin spitalor të jenë gjithmonë në dispozicion; dhe
- g) sigurojnë që përdorimi i kujdesshëm i antibiotikëve dhe parandalimi i rezistencës ndaj antibiotikëve të jenë "fusha prioritare të veprimit" në planin vjetor të spitalit tuaj.

Çka duhet të dini?

2. Programet e Kujdestarisë së Antibiotikëve, së bashku me praktikat e parandalimit dhe kontrollit të infeksionit, mund të rrisin sigurinë dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor të pacientit dhe të zvogëlojnë kostot spitalore në të gjitha shërbimet. Si rrjedhojë ato e përmirësojnë mënyrën e përdorimit të antibiotikëve, si dhe zvogëlojnë infeksionet nga *C. difficile* dhe ngjarje të tjera të padëshirueshme për pacientët [19,42].

Shembull:

Zbatimi i programeve të Kujdestarisë së Antibiotikëve ka rezultuar në [46]:

- *Uljen e konsumit të antibiotikëve me 20%,*
- *Uljen e incidencës së infeksioneve të fituara në spital,*
- *Shkurtimin e kohëzgjatjes së qëndrimit të pacientëve në spital dhe*
- *Uljen e kostove të antibiotikëve me 33%,*

3. Specialistët në fushën e sëmundjeve infektive, mikrobiologët klinikë dhe farmacistët klinikë janë të gjithë liderë kryesorë në ekipin e Kujdestarisë së Antibiotikëve [56,76].

4. Shumë mjekë dhe profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor besojnë se trajnimi i tyre në përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve është i pamjaftueshëm. Ata po kërkojnë udhëzime lokale për antibiotikët si dhe ekipe specifike të edukimit dhe Kujdestarisë së Antibiotikëve [25,27].

5. Klinikistët janë përgjegjës për përshkrimin e antibiotikëve dhe ata duhet të angazhohen plotësisht në vendimmarrje të përbashkët me ekipin e Kujdestarisë së Antibiotikëve [42].

6. Për të qenë të suksesshëm, ekipet e Kujdestarisë së Antibiotikëve kanë nevojë për mbështetjen aktive të profesionistëve të tjerë kryesorë në spitale, siç janë profesionistët e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve, mjekët e repartit të urgjencës, epidemiologët e spitalit, infermierët dhe stafi i IT [42,77].

7. Përmirësimi i përdorimit të antibiotikëve në repartin e urgjencës mund të çojë në përdorim më të mirë të antibiotikëve në gjithë institucionin, sepse reparti i urgjencës është një pikë e zakonshme e hyrjes në ambientin spitalor [77].

8. Masat kufizuese dhe masat për të bindur mjekët, mund të ndikojnë në uljen e përdorimit të antibiotikëve [19,43,54,56]:

- Masat kufizuese përfshijnë vendimet e para-miratimit dhe pas-autorizimit për antibiotikë specifikë;
- Masat bindëse përfshijnë auditimin proaktiv dhe sugjerimet nga infektologët, mikrobiologët dhe farmacistët .

9. Udhëzimet për përdorimin e antibiotikëve dhe seancat e rregullta edukative përmirësojnë mënyrën e menaxhimit të infeksioneve nga mjekët [78].

- Disa strategji strukturore mund të përmirësojnë përshkrimin e antibiotikëve dhe rezultatet e trajtimit të pacientit. Këto përfshijnë [54,79-81]:
- vendime të mbështetura nga kompjuteri, të cilat lidhin indikacionin klinik, të dhënat mikrobiologjike dhe përshkrimin e të dhënave së bashku, dhe

- përdorimin e testeve diagnostikuese të shpejta në pikën e kujdesit shëndetësor.

Çka mund të bëni në spitalin tuaj?

10. Mbështetni ekipin tuaj multidisciplinar të Kujdestarisë së Antibiotikëve duke caktuar liderë specifikë për llogaridhënien dhe ekspertizën lidhur me ilaçet dhe duke përcaktuar rolet mbështetëse të grupeve të tjera kryesore [42,71].

11. Jepni përparësi politikave të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve dhe të parandalimit e kontrollit të infeksioneve, si edhe strategjive dhe aktiviteteve që mbështesin përdorimin optimal të antibiotikëve dhe parandaloni përhapjen e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve [31,71].

12. Siguroni fonde dhe burime për programin e Kujdestarisë së Antibiotikëve (duke përfshirë p.sh., pagat për stafin e përkushtuar, kapacitetet e TI-së, testet diagnostikuese të shpejta dhe ato në pikën e kujdesit shëndetësor) [31].

13. Financoni dhe promovoni aktivitete edukative, trajnime dhe takime lidhur me Kujdestarinë e Antibiotikëve dhe rezistencën ndaj antibiotikëve për të gjithë profesionistët shëndetësor (mjekët, infektologët, farmacistët, mikrobiologët dhe stafi infermior) [19,53,56].

14. Fuqizoni aktivitetet e mbikëqyrjes për përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve dhe rezistencën ndaj antibiotikëve [56].

15. Promovoni respektimin e udhëzimeve e bazuara në prova për diagnostikimin dhe menaxhimin e infeksioneve të zakonshme dhe për profilaksinë antibiotike perioperative. Nëse këto udhëzime nuk ekzistojnë në spitalin tuaj, atëherë mbështetni hartimin e tyre [31,54,56].

16. Promovoni përdorimin e profilit lokal të mikrobiologjisë dhe rezistencës ndaj antibiotikëve për të përgatitur udhëzuesit dhe përzgjedhjen empirike të antibiotikëve [31].

17. Promovoni respektimin e udhëzimeve të bazuara në prova për masat e kontrollit të infeksioneve, për të zvogëluar transmetimin e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve [82].

18. Promovoni auditime proaktive dhe sigurohuni që përshkruesit të marrin sugjerime lidhur me përshkrimin individual të tyre [54,56].

19. Promovoni rishikimin e recetave të antibiotikëve dhe menaxhimit të infeksionit nga ana e kolegëve dhe inkurajoni komunikimin midis profesionistëve shëndetësor [71].